



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 3545/₁₄ Prot.

Tiranë, më 10/1/2013

Lënda: Rekomandim për “*Dhoma Kombëtare e Noterëve*”.

REKOMANDIM

Nr. 01 datë 10 / 01 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “*Dhoma Kombëtare e Noterëve*”.

KONSTATOVA

Më datë 1/10/2012 Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontrollin administrativ pranë kontrolluesit “*Dhoma Kombëtare e Noterëve*” me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Noterisë, për subjektet e të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, kofidencialiteti, masat e marra nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Noterisë për sigurinë e të dhënave personale (neni 27,28).

Kontrolli administrativ u krye në selinë e kontrolluesit “*Dhomës Kombëtare të Noterisë*” në prani të presidentes së tij, znj. Mimoza Sadushaj.

Kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*” në funksion të përmbushjes së qëllimit të vet, i cili është i është i shprehur në Statusin e Dhomës Kombëtare të Noterëve, “*përfaqësimi profesional i noterëve, koordinimi dhe zhvillimi e veprimtarisë juridike noteriale, për të kryer dhe realizuar një shërbimi juridik të pavarur, të paanshëm, profesional e kofidencial, si organ publik privat vetëqeverisës, mbledh, përpunon, ruan dhe administron të dhëna personale për kategorinë e subjekteve “noter”, “asistentë”.*

Kontrolli administrativ i ushtruar pranë kontrolluesit “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*” u fokusua tek kategoria e subjekteve të të dhënave personale “noter” dhe “asistentë”.

U inspektua gjatë kontrollit administrativ për kategorinë e të dhënave personale që kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*” mbledh, ligjshmërinë e këtyre të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, rregullat e marra për sigurinë kofidencialitetin, në aspektin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

Rezultoi nga kontrolli administrativ se të dhënat personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “noter” dhe “asistentë” të cilat mblidhen nga kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*”, mbahen në një regjistër elektronik të ndërtuar në listë emërore (excel) dhe lidhen kryesisht me *emrin, mbiemrin, datëlindje, të dhëna për diplomimin, licencimi, numri i telefonit e-mail, të dhëna mbi masat disiplinore të marra të cilat lidhen me subjektin e të dhënave etj.*

Sa i përket kategorisë së të dhënave personale që mblidhen për subjekteve të dhënave “noter” dhe “asistentë”, për mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes së tyre, nuk konstatohen shkelje të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

Por nga kontrolli administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare të Noterisë*” **nuk ka rregulla të shkruara dhe të përcaktuara qartë për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin për subjektet e të dhënave personale “noter”, “asistentë”,** si kundër parashikohet në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, gjë e cila konsiderohet shkelje e këtij ligji (nenet 27,28).

Gjithashtu si shkelje e ligjit konsiderohet dhe **deklarimi në mënyre të gabuar në disa nga rubrikat e plotësimit formularit të njoftimit**, që lidhen me fushën e veprimtarisë së kontrolluesit karakteristikat e sistemit të përpunimit të të dhënave personale, kategoria e subjekteve të të dhënave personale, qëllimi i përpunimit të të dhënave, bërë nga kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*”, pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si detyrim ligjor i nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

Përshkrimi i shkeljeve administrative mbështetja në ligj dhe prova

Gjatë kontrollit administrativ të ushtruar konstatohen shkelje;

- Kontrolluesi, “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*”, nuk ka rregulla të shkruara dhe të përcaktuara qartë për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike për subjektet e të dhënave personale “noter”, “asistentë” si kundër parashikohet në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.
- Kontrolluesi, “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*”, ka plotësuar në mënyre të gabuar disa nga rubrikat e formularit të njoftimit pranë Zyrës së komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si rubrika që lidhet me fusha e veprimtarisë, qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, kategoria e subjekteve të të dhënave personale etj.

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”

Neni 27 – “*Masat për sigurinë e të dhënave personale*”

Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi

Neni 21- "Përgjegjësia për të njoftuar"

Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të nenit 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" kontrolluesi "*Dhoma Kombëtare e Noterisë*", brenda 45 ditëve të marrë masa për hartimin e rregullave ose përfshirjen në rregulloren e përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Noterëve, të klauzolave dhe dispozitave që rregullojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në këtë ligj.
- 2) Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", brenda 10-ditëve të rishikojë njoftimin e bërë pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke deklaruar saktë, veprimtarinë, qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, kategoria e subjekteve të të dhënave personale etj
- 3) Kontrolluesi "*Dhoma Kombëtare e Noterisë*", mbas përmbyshjes së këtyre rekomandimeve mbart detyrimin për të njoftuar Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 4) Me kalimin e këtyre afateve në rast mospërmbyshje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit...*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

